



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. _____ Prot

Datë 29/10/2024

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

SMART PARKING NE KALANE E BERATIT

VLERA E FONDIT LIMIT: 5 265 500 (pese milion e dyqind e gjashtedhjet e pese mijë e peseqind)
leke pa Tvsh,.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ”**Bashkia Berat**”, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit që prokurohet. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

- 2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohehet për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe nenit 41 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilin është përcaktuar se: [...]3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 41 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo me te vogel se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar

- 2.3.1** Operatori ekonomik duhet te paraqes certifikate CE për mallrat pjese e procedurës se prokurimit ne veçanti për : 1) Pajisje per leshimin dhe matjen e kohes e parkimit, me ekran dhe aksesore; 2) Pajisje per kontrollin e pageses se parkimit me display dhe aksesore; 3) Pajisje bariere per kontrollin e levizjes se mjeteve (te komandueshme nga sistemi i parkimit);

Argumentimi :

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Shenjimi CE per mallrat eshte nje detyrim per cdo pajisje qe tregtohet ne Republiken e Shqiperise. Shenjimi CE pervecse detyrim ligjor per cdo pajisje fizike eshte edhe nje garanci qe pajisjet jane te nje standarti, cilesie te larte.

- 2.3.2** Operatori Ekonomik duhet te paraqes Autorizim prodhuesi ose Distributori te autorizuar për zërat : 1) Pajisje per leshimin dhe matjen e kohes e parkimit, me ekran dhe aksesore; 2) Pajisje per kontrollin e pageses se parkimit me display dhe aksesore; 3) Pajisje bariere per kontrollin e levizjes se mjeteve (te komandueshme nga sistemi i parkimit); 4) Software qendror per menaxhimin e qenderzuar te sistemit te parkimit. Autorizimi i prodhuesit duhet te lëshohet ne emër te autoriteti kontraktor dhe duhet te përmbajë te dhëna te plota si e-mail, numër kontakti, adrese, faqe web te prodhuesit, kjo ne rast verifikimi nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi:

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për territorin e Shqipërisë për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanton që produktet që kërkohen të blihen janë prodhuar/krijuar sipas standardeve të larta nga prodhues të njohur zyrtarisht. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për të garantuar që Operatori Ekonomik ka mbështetjen dhe suportin e prodhuesit për të garantuar cilësinë e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

produkteve dhe furnizimin e tyre ne kohe për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e pajisjeve ne kushtet e garancisë dhe pas saj.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te jete i certifikuar si me poshtë. Për plotësimin e kësaj kërkesë ofertuesi duhet te paraqesë certifikatën e kërkuar për:

- ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit te cilesise” (e vlefshme) ose ekuivalent
- ISO 27001:2013 “Sistemi i menaxhimit te sigurise se informacionit” (e vlefshme) ose ekuivalent

Certifikimi I kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 te VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzoje certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Duke qene se paisjet e kerkuara jane per sisteme sigurie dhe arketimi te te ardhurave si dhe teknologjia e kerkuar eshte e nje niveli te larte duhet qe subjektet zbatuese te kontrates te jene te pajisura me keto certifikime.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përmbushja e standartit ISO 9001 ose ekuivalent është i rendesishem per te siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

Certifikimi ISO 27001 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës duke siguruar që informacionet të menaxhohen në mënyrë të sigurtë duke qenë sistemi perpunon dhe administron informacione dhe të dhena të rendesishme dhe sensitive. Ky certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet nderkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës.

- 2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar për muajin e fundit jo më pak se 5 (pese) punonjës në listë pagesë, i vlerësuar si afat minimal kohor është i nevojshëm për garantuar sigurimin e eksperiencës dhe përvojës së mjaftueshme personelit të OE për njohjen e veçorive, specifike të mallrave që do të prokurohen. Për këtë duhet të paraqesë liste pagesat e muajit të fundit.

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Operatori ekonomik fitues duhet të disponojë staf të mjaftueshëm për zbatimin me sukses të gjithë kërkesave që përfshijnë punime ndertimore për ndertimin e bazamenteve të betonit, punime elektrike për lidhjen e pajisjeve me rrjetin e energjisë, staf që do të kujdeset për lidhjen në rrjet të sistemeve, staf që do të bejë të mundur montimin e pajisjeve të parkimit, konfigurimin e tyre dhe mirembajtjen në vazhdimësi.

- 2.3.5** Operatori Ekonomik duhet të ketë minimalisht 1 inxhinierë elektronik ose informatike, të certifikuar në të paktën një nga pajisjet e kuotuarat. Për këtë duhet të paraqesë liste pagesat e muajit të fundit, certifikatat e diplomat përkatëse.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Bashkia Berat, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Eshte shume e rëndesishme qe personat qe do te ndjekin instalimin e pajisjeve pjese e procedures duhet te jene te certifikuar si inxhiniere te fushes. Kjo siguron qe implementimi do te jete i suksesshem.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka minimalisht për periudhën muajin e te fundit punonjës të profilizuar si më poshtë:

- 2 punonjes te certifikuar per ofrimin e suportit dhe mirembajtjes per sistemet e parkimit. Per kete duhet te paraqese certifikatat perkatese si dhe listepagesen e muajit te fundit.
- 2 (dy) punonjës të siguruar si montues të pajisjeve elektronike, kjo e vërtetuar me listpagesat e muajit të fundit sipas kodit perkates te profesionit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër.

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

objektit të prokurimit. Bashkia Berat, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Eshte kerkuar ky kriter pasi eshte shume e rëndesishme qe personat qe do te ofrojne mirembajtjen dhe suport te pajisjeve te jene te certifikuar. Kjo per te siguruar qe suporti do te jepet ne kohe dhe me garanci pergjate gjithe kohezgjatjes se saj. Montuesit/teknikët do të jenë personat e drejtpërdrejtë që do të angazhohen në kryejren e punimeve për furnizim-vendosjen e instalimet në pikat e caktuara nga AK etj.

Kjo procedurë është furnizim-vendosje dhe produktet e furnizuara do të montohen nga operatori ekonomik fitues i procedurës së prokurimit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga inxhinieri qe eshte dhe pjese e grupit te hartimit te projektit duke marrë në konsideratë, për blerjet e reja cilësore, kërkesat aktuale për funksionalitet zgjerim cilësi e përformancë si dhe shërbimet profesionale të kërkuara për teknologjite ekzistuese, ofrimin të produkteve të reja, karakteristikat e duhura bashkëkohore teknologjike, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në çdo rast ku ka qenë e mundur është përdorur termi “ose ekuivalent” për të qenë gjithmonë në konformitet me zbatimin e legjislacionit të prokurimeve publike dhe akteve nën-ligjore në zbatim të tyre.